

SKEMA E ÇERTIFIKIMIT PËR INSTALUESIT, MODERNIZUESIT/MODIFIKUESIT DHE MIRËMBAJTËSIT E ASHENSORËVE PËR PASAGJERË DHE MALLRA

KUSHTET PARAPRAKE

Aplikantëve; kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave u kërkohet familjarizimi me rregulloret teknike përkatëse, teknologjitë, standardet dhe praktikën e shfrytëzimit/përdorimit/instalimit/mirëmbajtjes të ashensorëve për pasagjere dhe mallra.

KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË:

GRUPIN "A" – Operator i certifikuar, që kryen instalimin e ashensorëve për pasagjerë dhe mallra.

GRUPIN "B" – Operator i certifikuar, që kryen modernizimin/modifikimin e ashensorëve për pasagjerë dhe mallra.

GRUPIN "C" – Operator i certifikuar, që kryen mirëmbajtjen e ashensorëve për pasagjerë dhe mallra.

Kandidati, që dëshiron të certifikohet në cilin do nga grupet e me sipërme, duhet të përmbushi parakushtet për certifikim fillestar ose ricertifikim të përcaktuara më poshtë:

- a) Të ketë mbushur moshën 18 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
- b) Të ketë mbaruar shkollën e mesme të përgjithshëm ose atë profesional, dega mekanike ose elektrike, ose arsimin e 8/9 vjeçar (kur aplikon për mirëmbajtës), duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplome, dëftesë, vërtetim etj.)
- c) Të disponojë certifikatën për sigurimin teknik elektrik të Grupi III, duke e dëshmuar me një kopje të sajë.
- d) Të plotësojë kërkesat e aftësive fizike sipas pikës 6 të kësaj skeme certifikimi, si: shikimi; dëgjimi dhe lëvizshmëria, dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet mjekësore kompetente dhe të jete jo më e vjetër se një vit.
- e) Të kenë të paktën 6 (gjashtë) muaj eksperiencë pune në instalimin/modifikim/modernizim/mirëmbajtje, duke e dëshmuar me një dokument. (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga pune dhënësi etj.)

Plotësimi i kërkesave paraprake, vërtetohet nga vlerësuesit paraprak. Nëse aplikanti plotëson kërkesat paraprake të skemës së certifikimit, atëherë, ai i nënshtrohet procesit të certifikimit dhe kryen pagesën paraprakisht. Në rast se aplikanti nuk i plotëson kërkesat paraprake, atëherë vlerësuesi paraprak, e lajmëron atë, (me shkresë zyrtare, ose me e-mail), për kriteret që ai nuk plotëson dhe procedura e certifikimit nuk fillon për të.

Shënim: Kandidati duhet të zotëroj gjuhen shqipe në të shkruar dhe të folur. Në rastet kur kandidati është i huaj, organi certifikues mund të sigurojë përkthimin, nëse do ketë kosto shtese do përballohet nga kandidati.